



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 59 datë 10.06 2026

**PËR "DHËNIEN NË PËRDORIM TË STADIUMIT "DURIM QYPI" DHE
AMBIENTEVE NDIHMËSE TË TIJ NGA ANA E BASHKISË PËRMET PËR OJF-NË
"KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET".**

Mbështetur në nenet 54 dhe 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenin 304 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 79/2017 "Për Sportin", LIGJ Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Përmet, të Qarkut të Gjirokastrës", Vendimin e Këshillit Bashkiak Përmet nr. 88, datë 05.11.2024 "Për themelimin e Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimin e Këshillit Bashkiak Përmet nr. 52, datë 02.06.2025 "Për miratimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimin nr. 7707, datë 05.03.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për regjistrimin e OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", si dhe kërkesën e OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. T'i jepet në përdorim OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet" Stadiumi "Durim Qypi" dhe ambientet ndihmëse të tij, pasuri në pronësi të Bashkisë Përmet me nr. pasurie 19/5 dhe 19/6, sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi të Bashkisë Përmet me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Përmet, të Qarkut të Gjirokastrës", për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë sportive të futbollit, pa pagesë.
2. OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" do të përdorë fushën e futbollit dhe ambientet ndihmëse vetëm për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj sportive.
3. Përdorimi i stadiumit dhe ambienteve ndihmëse jepet pa të drejtë ekskluzive. Bashkia Përmet ruan të drejtën e përdorimit dhe vënies në dispozicion të objektit për aktivitete të tjera publike, sportive ose institucionale.



4. Përdorimi i objektit do të vazhdojë për aq kohë sa OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Përmet dhe strukturat përkatëse të administratës së Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Enila DHIMITRI

